



Pranuar / Doretuar Prilbena/Prodato Received/Delivery	16.02.2023	3	viti god year
Organ /Ajesti Organ /Jedinstvo Org./Unit	Hi Prot Br. Pr.4 Prot No	Shkupja Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIAMSHK	1870/2023		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.11/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.11/2023 të datës 04.01.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit të datës 30.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga Shërbimi Civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.02.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.11/2023 e datës 04.01.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 30.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës, më datë 04.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 12/2023 e regjistruar nën shenjen A.nr.11/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 30.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë duke u bazuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike si dhe në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankuesit në Komunën e Prishtinës, ndërsa më datë 23.01.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku më shkresat e këndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 12/2023 të datës 04.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër 01-112-1024 të datës 25.09.2015; Akt Emërimit me numër 01-112-1024 të datës 01.10.2016; Vendimin me numër protokoll 14-112/02-0310543/17 të datës 21.12.2017; Vendimin A.nr.316/2022 të datës 11.05.2022 të KPMSHCK-së; Vendimin me numër 14-020/01-108671/22 i datës 10.05.2022; Ankesën e ankueses e datës 20.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës nga ankuesi më datë 06.07.2022; Vendimin A.nr.550/2022 i KPMSHCK; Emailin e datës 22.08.2022 nga ankuesi për M.Ll; Emailin e datës 17.08.2022 nga M.Ll për ankuesin; Emailin e datës 17.08.2022, 16.08.2022, 12.08.2022, 08.08.2022. 02.06.2022 nga ankuesi për M.Ll; Emailat e datave 09.08.2022, 20.05.2022 nga M.Ll për ankuesin; Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112-1022 të datës 01.06.2022; Emailin e datës 13.06.2022 nga V.M për F.A; Emailin e datës 02.06.2022 nga ankuesi për M.Ll; Raportin e një shkelje disiplinore të supozuar e datës 20.06.2022; Padinë e datës 02.09.2022; Konkursin me Nr. Reference: RN00010067 të datës 04.10.2022 për pozitën Udhëheqës i Sektorit Ligjor; Kërkesën për anulimin e konkursit për Udhëheqës të Sektorit Ligjor e datës 18.10.2022 e parashtruar nga ankuesi; Kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit e parashtruar nga ankuesi në Gjykatën Themelore në Prishtinë; Kërkesën për rihapjen e procedurës e datës 18.10.2022 e parashtruar nga ankuesi tek Kryetari i Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 21.10.2022 për ankuesin nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore; Formularin për raportimin e shkeljes disiplinor i datës 19.10.2022 me numër protokoll 14-116/02-228179/22; Emailin e datës 14.11.2022 nga A.K për ankuesin; Kërkesën për qasje në dokumente publike e datës 07.11.2022 nga ankuesi për A.K; Pasqyra e llogarisë nga TRUSTI për ankuesin për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2021; Vendimin e datës 18.11.2022 të Komisionit Disiplinor; Fletëthirrjen e datës 22.11.2022; Konkursin me numër reference RN00010480 për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale; Vendimin e datës 30.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Dëshmi për postë e datës 01.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 297/2023 e datës 13.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 702/2023 e datës 23.01.2023; Fletëthirrjen e datës 15.11.2022 për ankuesin; Flete dorëzimit e datës 14.11.2022 për V.M; Emailin e datës 06.06.2022, 13.06.2022, 20.06.2022 nga V.M për F.A; Lista e ardhje/vajtjeve në punë për Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë për datat 01-10.06.2022 dhe 15-25.08.2022; Flete kthimi i datës 05.12.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 22.11.2022, 15.11.2022; Vendimin me Nr. 14-112/002-0204360/17 i datës 16.08.2017 për pezullim të dakorduar; Emailin e datës 25.08.2022 nga M.Ll për ankuesin; Emailin e datës 22.08.2022 nga V.M për M.Ll; Emailin e datës 22.08.2022 nga M.Ll për V.M.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimit i provave materiale rezulton së ankuesi sipas Akt-it të Emërimit me Nr. 01-112-1024 të datës 01.10.2016 është emëruar në pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit Ligjor* në Komunën e Prishtinës, ndërsa me Vendimin Nr.14-112/02-0204360/17 të datës 16.08.2017 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ishte është bërë pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës së ankuesit në Shërbimin Civil, për shkak të emërimit të ankuesit si funksionari publik gjegjësisht Drejtor i Drejtorisë Komunale të Urbanizimit në Komunën e Prishtinës.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi, pas heshtje së organit të punësimit për kthim në Shërbim Civil pas përfundimit të mandatit të funksionarit publik, ankuesi më datë 31.03.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim për kthim në vendin e punës *Udhëheqës i Sektorit Ligjor*, ndërsa Këshilli më Vendimin A.nr.316/2022 të datës 11.05.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës që ankuesin ta kthejë në pozitën *Udhëheqës i Sektorit Ligjor* ose në një pozitë tjetër ekuivalente. Duke vepruar sipas vendimit të Këshillit, Kryetari i Komunës së Prishtinës me Vendimin Nr.14-020/01-108671/22 të datës 17.05.2022 ka sistemuar ankuesin në pozitën *Udhëheqës i Njëjesisë 1*, në kuadër të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale pasi që pozita e ankuesit *Udhëheqës i Sektorit Ligjor* ka qenë e zënë. Kundër këtij vendimi, ankuesi më datë 20.06.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.550/2022 të datës 03.08.2022, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ.

Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Prishtinës, më datë 19.10.2022 ka paraqitur kërkesën për raportimin e shkeljeve disiplinore të ankuesit, me arsyetimin se në cilësi të mbikëqyrësit të ankuesit më datë 01.06.2022 kishte pranuar Akt Emërimin me numër 01-112-1022 të ankuesit, ku i njëjti deri më datë 19.10.2022, nuk është paraqitur në punë edhe se për këtë kishte njoftuar tri herë radhazi Zyrën e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës më Vendimin e datës 30.11.2022, ka shpallur ankuesin përgjegjës për shkelje disiplinore të rëndë nga nenin 46 paragrafi 3 nen paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore "*largim nga shërbimit civil*".

Ankuesi kundër Vendimit të datës 30.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar është nxjerrë duke u bazuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike si dhe në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Thekson së marrëdhënia e punës themelohet me Akt Emërim të cilën ankuesi nuk e ka pranuar dhe nënshkruar, nuk janë plotësuar elementet e përgjegjësisë disiplinore dhe se inicimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent për shkak që z. Mujku nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejt.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë procedurën dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: "shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore.

2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë" ndërsa "Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".

Nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor".

Neni 50 paragrafi 1 dhe 2, kanë përcaktuar se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer".

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë si dhe duke u bazuar në vlerësimin e provave të çështjes, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 30.11.2022 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit "Lirim nga Shërbimi Civil", si dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, pasi që nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi me datë 20.05.2022, 01.06.2022 dhe 02.06.2022 ishte njoftuar përmes emailit nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës lidhur me Vendimin Nr.14-020/01-108671/22 të datës 17.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për sistemin e tij në pozitën e Udhëheqësit të



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.11/2023.

Avdyll BEKTESHI

*Behteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

*Ardita*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.